
THE VOICE OF OTHER IN “THE HISTORY OF SCANDERBEG” BY NAIM FRASHERI AND JERONIM DE RADA

Meral Shehabi-Veseli, MA

Southeast European University, Tetovo, Macedonia m.shehabi@seeu.edu.mk

Abstract: Intertextuality is a modern notion, discovered by Julia Kristeva, a renowned scholar. With the discovery of this notion, we have been provided with the opportunity to investigate the subtext spaces in literary texts in general. The voice of other in the works of various different authors has always been present, although authors of this era were not aware of the presence of the phenomenon of intertextuality as such. The notion of other as ideology in Albanian literature is a search of something, which was not a practice of previous theoretical-literary studies. This phenomenon implies the presence of the voice of other that exists outside and inside a literary text. The retakes from history became tradition in the literature of the National Renaissance period. The history in the poems in question appears as a literary hipotext, according to Gérard Genette’s terminology. In the mentioned poems, we can notice a combination of history and imaginary events. The placement of historic dates at the beginning of songs in Jeronim de Rada’s poem “Skenderbeu i Pafan”, speaks openly about the intertextual correlation of the poem and the history. The explicit and/or implicit support for our national hero is present in the *histories* of both authors, who are a subject of this study. Most of the authors managed to create their own epopees by referring to Scanderbeg; however, de Rada was called Albania’s Dante thanks to such a reference of his. Histories follow the chronology of historic events, which appeared earlier in Marin Barleti’s “History of Scanderbeg”. This means that the chronology of historic events in the named poems is based on the fifteenth century. We can refer to Umberto Eco’s concept in this case, who talks about the support relation between two authors, A and B. He says that if we do not put an X at the top of the triangle, which is called the universe of the encyclopedia, we cannot talk about the intertextual rapport in literature, philosophy, etc. In our concrete case, based on Eco’s theory, A is chronologically ahead of B. this means that De Rada’s work can be A, and Naim Frasheri’s work would be B because it comes after the former. The X at the top of this triangle would be Marin Barleti’s “History of Scanderbeg”. If we analyze the poems in more depth, we will see that they make use of an intensified intertextual relation even with Greek poems. At the beginning we have the call made to the muse asking for help, as an innuendo in Greek epopees. On the other hand, in the verses of the 13th song of the “History of Scanderbeg” we can find intertextual elements, which appear as reminiscences, referring to Dante and Plato. The reliance on history and historical figures results successfully in the works of authors of the Renaissance era. This reliance, aiming at increasing the awareness, on one hand, and using history for adding some more literary weight to those works, on the other, opens up the possibility for the works of this period to find some support even in mythology, which is in function of the intertext.

Keywords: other, intertextuality, history, Naim Frasheri, De Rada.

ZËRI I TJETRIT NË “HISTORINË E SKENDERBEUT” TË NAIM FRASHËRIT DHE TË JERONIM DE RADËS

Meral Shehabi-Veseli, Mr.

Universiteti i Evropës Juglindore-Tetovë, Republika e Maqedonisë,
m.shehabi@seeu.edu.mk

Abstrakt: Intertekstualiteti është nocion modern, i zbuluar nga studiuesja Julia Kristeva. Me zbulimin e nocionit të intertekstualitetit, paraqitet mundësia që të hetohen hapësirat e nëntekstit në tekstet e letërsisë në përgjithësi. Zëri i tjetrit në veprat e autorëve ka qenë i pranishëm gjithëherë. Megjithëse, autorë e kësaj periudhe nuk kanë qenë të vetëdijshëm për prezencën e fenomenit të intertekstualitetit. Nocioni i tjetrit si ideologji në letërsinë shqipe, është kërkim i diçkaje, që nuk ka qenë praktikë e studimeve të më hershme teoriko-letrare. Ky fenomen nënkupton praninë e zërit të tjetrit që gjendet brenda dhe jashtë një teksti letrar. Rimarrjet nga historia janë bërë traditë në letërsinë e Rilindjes Kombëtare. Historia në poemat në fjalë paraqitet si hipotekst letrar sipas terminologjisë së Zherar Zhenetit. Në poemat hetohet gërshetim i historisë me ngjarje imagjinare. Vënja e datave historike në fillim të këngëve te poema “Skenderbeu i Pafan” i Jeronim de Radës, hapur flet për lidhjen intertekstuale të poemës me historinë. Mbështetja eksplicite e herë implicite në heroin kombëtar, është prezente në të dy *Historit* e autorëve që

janë objekt i studimit. Shumica e autorëve duke iu referuar Skenderbeut krijuan epopetë e tyre, por De Rada me një referim të tillë u quajt *Dante* i Shqipërisë. Historitë ndjekin edhe kronologjinë e ngjarjeve historike, të cilat janë paraqitur më herët në “Historinë e Skenderbeut” të Marin Barletit. Pra, ecuria e ngjarjeve historike në poema mbështetet në shekullin e XV. Në këtë radhë mund t’ju referohemi konceptit të Umberto Ekos, i cili flet për marrëdhënien e mbështetjes mes dy autorëve A dhe B. Ai thekson se nëse nuk vihet në majë të trekëndëshit një X, i cili emërohet si gjithësia e enciklopedisë, nuk mund të diskutohet për raportin intertekstual në letërsi në filozofi etj. Në rastin konkret bazuar në teorinë e Ekos, A-ja është kronologjikisht para B-së, mund të quhet vepra e De Radës, B-ja që është pas A-së mund të quhet vepra e Naim Frashërit dhe me automatizëm X që gjendet në majë të këtij trekëndëshi është “Historia e Skenderbeut” e Marin Barletit. Nëse analizohen poemat më thellësisht ata përdorin raport të intensifikuar intertekstual edhe me poemat greke. Në fillim kemi thirrjen që i bëhet muzës për ndihmë e cila ka funksionin e si aluzionit ashtu si në epopetë greke. Derisa në vargjet e këngës së XIII të “Historisë së Skenderbeut”, gjejmë elemente intertekstuale, të cilat paraqiten si reminishenca, që i referohen Dantes dhe Platonit. Mbështetja në histori dhe në figurën historike, rezulton me sukses në veprat e autorëve të Rilindjes. Kjo mbështetje, e cila ka qëllim të ngritjes së vetëdijes, në njërin anë dhe në anën tjetër përdorimin e historisë për fitimin e vlerave letrare, hap mundësinë që veprat e kësaj periudhe të gjejnë mbështetje edhe në mitologji, që është në funksion të intertekstit.

Fjalët çelës: Tjetri, Intertekstualiteti, Historia, Naimi, De Rada.

1. HYRJE

Historia paraqet një nga burimet kryesore për rimarrje të fillit me të cilin do të enden veprat letrare. Autorë të gjithë periudhave në veprat e tyre i referohen historisë. Atje ka ngjarje, luftra dhe heronj që ia vlen të përrjetësohen edhe në veprat letrare. Rimarrja e materialit nga historia është bërë traditë për autorët e Rilindjes kombëtare. Ata, duke pasur qëllim vetëdijësimin e popullit, shpesh, i referohen historisë shqiptare për ngritjen e vetëdijes por edhe për t’i pasuruar veprat e tyre me ngjarje e personazhe historike të rëndësishme. Komunikimi me historinë është më tepër i dukshëm në poemën e De Radës, “Skenderbeu i pafan” dhe në poemën e Naimit “Istori e Skenderbeut”. “*Te historia kemi të bëjmë me tregimin e ngjarjeve (ndodhive), qofshin këto të zgjedhura, të dëshiruara dhe të dëshmuara. Vetë mënyra e paraqitjes kushtëzohet një tip të shkrimit që mbështetet në tregimin dhe tregimi është një trajtë themelore e ndërtimit të tekstit, që vërtetësinë e vet të paraqitjes së jetës e mbështet në dëshmitë dhe në të dhënat*”... “*De Rada me “Skenderbeun e pafan” përpiket të rindërtojë një të kaluar heroike arbërore; Naimi me “Historinë e Skenderbeut” krijon portretin trimëror e moral për të ngjitur në ballin e heronjve kombëtarë*”¹³⁷

2. VËZHGIMET TEORIKE NË VEPRËN “SKENDERBEU I PAFAN” TË DE RADËS SIPAS ZHERAR ZHENETIT

Vepra e De Radës “Skenderbeu i Pafan” karakterizohet me një dialog të intensifikuar letrar me historinë. Duke pasur parasysh faktin që De Rada i përpunon veprat e tij, kjo vepër në versionin e dytë do të quhet “Rënia e mbretërisë së Shqipërisë”, të cilën nuk arriti që ta botojë. Që nga titulli, te të dy versionet, kemi të dhëna paratekstuale që na flasin se tema është marrë nga historia e popullit. Jo, vetëm që historia është element që përdëfton prezencën e intertekstit në vepër, por ajo dëshmon respektimin e parimit të njohur romantik, kthimin në të kaluarën. J.Kristeva në esenë: “Problematika e strukturimit të tekstit”, thekson që: “*Nocioni i intertekstualitetit, do të jetë shenjë për mënyrën në bazë të cilës, një tekst e lexon historinë dhe shkruhet në të.*” Në veprën “Poetika” Aristoteli shkruan: “*Nuk është punë e poetit të rrëfejë për atë që ka ndodhur, por për atë që ka mundur të ndodhë, ose pse është e mundshme, ose pse është e domosdoshme. Historiani dhe poeti, në të vërtetë nuk dallohen, pse njëri flet në vargje e tjetri në prozë sepse veprat e Herodotit mund të viheshin në vargje dhe do të mбетeshin përsëri vepra të historisë, pa marrë parasysh a janë në vargje apo në prozë, po ndryshimi është se historiani rrëfen për atë që ka ndodhur, ndërsa poeti për atë që ka mundur të ndodhë. Për këtë arsye poezia është më mendore dhe më e vlefshme se historia.*”¹³⁸

Që në parathënien e librit, autori na largon nga epopete greke, por një largim i tillë është i pashmangshëm sa i përket anës përmbajtësore. Veprën e fillon me prolog, si element i shpeshtë i tragjedi greke: “*Sipas Anton Nik Berishës, vepra “Skenderbeku i pafan” i De Radës nuk mbështete në argumente të mirëfillta historike të periudhës përkatëse, po është “histori” poetike, subjektive, rrëfim i imagjinatës dhe mesazh i lirë poetik. Ç`është e vërteta,*

¹³⁷ Sabri Hamiti, *Studime letrare*, Seksioni i gjuhësisë dhe i letërsisë, Libri 21, Prishtinë, 2003, faqe 736-737.

¹³⁸ Aristoteli, *Poetika*, Rilindja, Prishtinë, 1984, faqe 26.

Twelfth International Scientific Conference
KNOWLEDGE WITHOUT BORDERS
31.3-2.4.2017, Vrnjacka Banja, Serbia

*autori nuk e përmbys e as nuk i mohon ngjarjet historike, po e gjurmon jehonën e tyre, botën e brendshme të personazheve ose të vërtetën e mundshme të rrjedhës historike të qindvjetëshit të XV-të.*¹³⁹

Shekulli XV është periudha nga e cila autori nxjerr tema, për të ndikuar në shpirtin e shqiptarit dhe njëkohësisht zgjimin e identitetit kombëtar. Kënga e parë e veprës lidhet me ciklin epik të luftës në kufirin serbo-shqiptar. (*Skenderbuku i Pafan*). “Një nga pasuritë e intertekstualitetit është që ai përbën një lloj shkëmbyesi ndërmjet bibliotekës dhe historisë... çdo epokë rilexon nën dritën e aktualitetit të saj politik, ideologjik, shkencor, artistik... veprat e së kaluarës dhe iu mvësh atyre vlera që ajo i mbart në farë pa i shkoqitur.”¹⁴⁰ Poema më tepër shihet si epike sesa lirike. Personazhi kryesor është heroi kombëtar, Skenderbeu. Ai në poemë shfaqet si tregimtar i gjithëdijshëm, pasi rrëfen dhe njëkohësisht vetërrëfëhet. Rrëfimi është në vetën e parë. Në këtë mënyrë poema afrohet me lexuesin.

Studiuesi Rexhep Qosja në lidhje me këtë vepër mban tezën se: “më dukshëm se në poemat tjera Jeronim de Rada, e shquan historinë në poemën “Skenderbuku i pafan” për dy arsye kryesore:

*E para, për arsye që disa prej ngjarjeve që në të trajtohen janë ngjarje, vërtet historike, me protagonist dhe me rrjedhime historike. E dyta, për arsye se vënia e Skenderbeut si fytyrë historike në prapavijën e këtyre ngjarjeve, vetvetiu e obligon autorin që të ketë kujdes shumë më të theksuar për historinë sesa në poemat e përparme, domethënë më të theksuar sesa në poemat tjera.”*¹⁴¹

Emrat Radovani, Milloshini janë emra imagjinari, por nuk përjashtohet mundësia e përdorimit të emrave historik, si emri i Skenderbeut. Poashtu, shumica e këngëve që përdoren janë historike, me synim të krijimit të një ambienti historik. Në librin e parë të këngës së dhjetë është përdorur alegoria për babain e Gjergj Kastriotit, e cila është e dokumentuar në aktet diplomatike të Shqipërisë. Periudha e Rilindjes njihet si periudhë, e cila më tepër krijon marrëdhënie intertekstuale me letërsinë e vjetër, historinë, mitin dhe me letërsitë e popujve tjerë që krijuan njëkohësisht.

Elementi intertekstual është prezent, që nënkupton se teksti bazë i ofron material tekstit të ri, i cili është si produkt i këtij teksti parësor, në rastin konkret këto janë këngët e korreve. Nëse këto këngë nuk janë përdorur në rapsoditë shqipe, i hasim dendur në poemat greke, që kanë mundur t'i shërbejnë De Radës si material parësor për veprat e tij.

De Rada sikur dialogëzon edhe me poemat e veta të mëhershme, pasi ai gjithmonë personazhet e tij i transformon edhe në poemat tjera. Disa personazhe të poemës “Serafina Topia” hasen tek poema “Skenderbeu i pafan”. Qëllimi i tij është ndoshta që të sugjerojë vazhdimësi historike në poemat e mëvonshme.

Poema nuk ka vetëm ngjarje historike, por edhe imagjinare. Ngjarjet historike i shërbejnë për ta shquar heroizmin e popullit shqiptar, por ato nuk janë të ndara nga ngjarjet imagjinare. Me kalimin nga ngjarjet historike në ata imagjinare, ai sikur e shkëput historizmin e poemës. “Sikundër e tregojnë edhe datat në fillimet e këngëve, ngjarjet e shtjelluara në poemat e tij, doemos ruajnë kronologjinë. Është e qartë se De Rada kujdeset që në poemat e tij të imitoj historinë.”¹⁴²

Data në fillimet e këngëve referojnë në data historike. Kjo e dhënë paratekstuale, i ndihmon lexuesit në pikasje të intertekstit historik. “Poema “Skenderbuku i pafan” ndahet në libra që mbulojnë etapa të caktuara historike, kurse librat ndahen në këngë, që mbulojnë ngjarje të veçanta të këtyre etapave. Në dy librat e fundit të poemës, këngët, ndërkaq, quhen histori.”¹⁴³

Qëllimi i poetit është që, nëpërmjet këtyre të dhënave paratekstuale, sipas terminologjisë së ZH. Zhenetit, të shfaq historinë e popullit në vargje. Edhe datat në fillim të këngëve, referojnë në ngjarje historike. Historia i nënshtrohet një lloj rikrijimi në këto vepra. Nuk mund të mos hetohet se në poemë hasen edhe ngjarje imagjinare, por në krahasim me historinë që mbisundon trillimet janë më të pakta.

Si marker të intertekstit paraqiten edhe toponimet Shkodra, Dibra, Kruja, Berati, Mirdita e të tjera, këto toponime janë dhënë në fillim të këngëve, bashkë me datat historike. Këto marker të intertekstit si: datat, emrat e personazheve, toponimet dëshmojnë se vepra dialogëzon me historinë e shekullit XV, duke e rikrijuar të njëjtën artistikisht. Autori lëviz nga historia në imagjinatë, këtë lëvizje e bën me qëllime të caktuara, që të mos mbetet plotësisht i robëruar nga ngjarjet historike. De Rada vendos dialog edhe me toponimet arbëreshe, të cilat i vendos në

¹³⁹ Letërsia dhe kultura arbëreshe, *Jeronim de Rada në 200 vjetorin e lindjes*, Rama graf, Elbasan, 2015, faqe 68.

¹⁴⁰ Nathalie Piegay Gros, *Poetika e intertekstualitetit*, përkth. Urim Nerguti, Prishtinë, Parnas. 2001, faqe 123.

¹⁴¹ Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi II*, Toena, Tiranë, 2000, faqe 110-111.

¹⁴² *Ibid.*, faqe 117.

¹⁴³ *Ibid.*, faqe 111.

rrjedhën e ngjarjeve historike. Derisa, gjatë paraqitjes së ngjarjeve historike, në disa raste, kemi mospërputhje me të vërtetën historike, në këtë rast këto ngjarje, mund të emërohen edhe si ngjarje *mbihistorike*.

Ngjarjet, ashtu si te poemat historike, e ruajnë kronologjinë e tyre. Kronologjia e poemave, si te “Skenderbeu i pafan” i De Radës, ashtu edhe “Historia e Skenderbeut” e Naim Frashërit i dëmtojnë poemat, të cilat nuk mund të jenë poema epike, pasi sipas Aristotelit “*poezia epike, nuk duhet t’u shëmbëllejë veprave historike në të cilat objekti i paraqitjes, doemos, është jo një ngjarje, por një kohë, domethënë paraqitja e gjithë asaj, që në atë kohë i ka ngjarë njërit e jo shumicës, kurse çdonjëra prej këtyre ngjarjeve ose është ose nuk është e lidhur me ndonjë ngjarje tjetër...ashtu edhe në kohët që vijnë njëra pas tjetrës ngjajnë, ngjarje njëra pas tjetrës, prej të cilave asnjëra s’kanë farë qëllimi të përbashkët me tjetrën.*”¹⁴⁴

Lidhja intertekstuale në veprat e De Radës është polivalente, e shumanshme, por zbulimi i këtyre elementeve, kërkon një lexues me bagazhë të pasur kulturor, por edhe njohës të gjuhëve që i flet dhe shkruan vet autori. Vet fakti që ai shkruan në dy gjuhë, e hap mundësinë e përsëritjes dhe formimit të lidhjes intertekstuale. *Identiteti kulturor paraqitet si intertekst sipas B.S. Zllatku, (Paradigma intertekstuale në veprimtarinë e De Radës)*. Me veprën e tij, De Rada do t’u mundësojë mbështetje krijuesve arbëresh dhe me epitete të larta do të cilësohet nga kritika e kohës. Shumica do ta quajnë *Homer shqiptar, Dante apo Makferson të Shqipërisë.*”

3. MBËSHTETJA NË HISTORINË E BARLETIT SIPAS TREKËNDËSHIT TË UMBERTO EKOS

Mbështetja eksplicite ose implicite në figurën e heroit kombëtar, në periudhën e Rilindjes u krijua si traditë. Çdo shkrimtarë i periudhës së Rilindjes shkruan për heroin kombëtar dhe ngjarjet e shekullit XV. Mbase, De Rada ishte i pari, i cili shkroi për figurën e Skenderbeut. Megjithatë, Naimi në poemën e tij “Histori e Skenderbeut”, do të jetë më i suksesshëm se autorët pararendës që e trajtuan këtë temë.

Umberto Eko¹⁴⁵ në esenë e tij “Borhesi dhe ankthi im i ndikimit “flet për marrëdhënien e mbështetjes mes dy autorëve A dhe B.

1. A dhe B kanë shkruar në të njëjtën kohë. Mund të diskutojmë, për shembull, nëse ka pasur një marrëdhënie mbështetjeje mes Prustit dhe Xhojsit. Nuk ka pasur, janë takuar vetëm njëherë dhe secili ka thënë pak a shumë për tjetrin.
2. A-ja kronologjikisht është përpara B-së, prandaj diskutimi ka të bëjë vetëm me mbështetjen e A-së te B-ja.

Por Eko flet se nuk mund të diskutojmë për raportin intertekstual në letërsi, në filozofi, dhe në kërkimet shkencore, po nuk vure në majë të trekëndëshit një X. Këtë X e quan gjithësia e enciklopedisë.



Marrëdhënia A/B mund të vendoset në mënyra të ndryshme:

1. B-ja gjen diçka në veprën e A-se dhe nuk e di se pas është X;
2. B-ja gjen diçka në veprën e A-së dhe me anë të veprës së A-së ngjitet deri tek X-i;
3. B-ja i referohet X-it dhe vetëm më pas kujtohet që X-si ishte në veprën e A-së.

Pra e njëjta ndodh edhe me autorët tanë, De Radën dhe Naim Frashërin, në veprat e tyre “Skenderbeu i Pafan” dhe “Historia e Skenderbeut”. Në këtë rast, A-ja që mund të jetë De Rada është përpara B-së që mund të jetë Naimi. Prandaj, këtu mund të flasim për mbështetjen e B-së te A-ja, nuk përjashtohet mundësia që edhe X-i që ishte në veprën e A-së njëkohësisht të mundësojë që B-ja të ngjitet tek X-si, i cili emërohet si gjithësia e enciklopedisë, sipas Ekos, e që në rastin konkret cilësohet si vepra e Marin Barletit, “Historia e Skenderbeut”.

“Për këndimin e Skenderbeut në veprën e Naimit janë kërkuar dy motive të hershme. Njërin e thekson biografia i tij i parë:”*Duke parë që ky komb (grekët S.Hamiti) mburret me njerëzit e me vendin e tij, Naimit e të vëllait Samiut, q’ish bashkë në shkollët, u vinte dëshirë që të kenë edhe Shqiptarët me se të mburren, edhe përpiqeshin të gjenin në historitë të Shqipërisë njerëz dhe vepra që të na apin nder” “si dëshirë të Naimit që kur ishte nxënës, që të gjente në historinë e popullit të vet figura të lavdit të përgjithëshëm, siç i kishin edhe popujt tjerë.*¹⁴⁶”Një studiuës

¹⁴⁴ Aristotel, *U pesnickoj umetnosti*, Zavod za izdavanje ucebника Socijalisticke Republike Srbije, Beograd, 1966, faqe 32.

¹⁴⁵ Umberto Eko, *Për letërsinë*, Përkth. Donika Omari, Dituria, Tiranë, 2007.

¹⁴⁶ Lumo Skendo, *Naim Frashëri*, Botimi i tretë, Tiranë, 1941.

tjetër, (Krist Maloki) “këndimin e Skenderbeut në veprën poetike të Naimit, e lidh me një zgjim të përnjëhershëm të personës së poetit tonë, i cili zgjim shpërthen e do të bëhet zgjim i përgjithshëm kombëtar.”¹⁴⁷

4. ELEMENTET INTERTEKSTUALE NË VEPRËN “HISTORI E SKENDERBEUT” TË NAIMIT

“Historia e Skenderbeut” e Naimit “... është edhe histori sikundër i thotë titulli por edhe poemë epike-sikundër e thotë trajta e saj. Ajo është vepër në të cilin përshkohen historia dhe poezia herë në dëm të historisë e herë në dëm të poezisë, gjithsesi më dukshëm sesa epopetë e njohura të letërsisë evropiane, që në këtë rast do të jenë gjedhe krijuese të Naim Frashërit.”¹⁴⁸

Kjo poemë dialogëzon me ngjarjet historike dhe heroin kombëtar, por përsëri fillimi i poemës, i referohet poemave greke, pasi, Naimi në fillim fton engjëllin, që ta ndihmojë në hartimin e veprës letrare. Një veprim të tillë e afron me poemat greke *Ilijadën* dhe *Odisenë*. Muza e epopeve greke transferohet në *Engjëll*. Ky engjëll do të këndojë për heroizmat e Skenderbeut, me këtë do të ndikojë tek populli ose lexuesi i poemës. Vepra, nuk mund të themi se nuk ndryshon nga epopetë greke, pasi Naimi vazhdon të përdor vargun tetërokësh që është karakteristik për romantizmin shqiptar. Poema fillon duke kënduar:

“Këndo Engjëll, urtësinë,
Edhe gjithë mirësitë

Skenderben` e trimërinë,
Q`i dha Shqipërisë dritë.”¹⁴⁹

Letërsia shqiptare e kësaj periudhe ishte letërsi e angazhuar me ngjarjet politike dhe shoqërore të kohës. Si të tillë autorët iluministë nuk arritën që të krijojnë vepra me vlera të larta letrare, pasi kjo letërsi që dialogëzon edhe me ngjarjet shoqërore të kohës shkon në dëm të vlerave artistike.

“Istoria e Skenderbeut” e Naim Frashërit, që në të dhënë paratekstuale, na njofton me marrëdhënien që krijohet mes poemës dhe historisë. Kjo poemë që quhet histori i referohet historisë dhe ngjarjeve heroike. Pavarësisht se është e ndërtuar në vargje, vepra përsëri arrin të paraqes ngjarjet historike që si referencë kanë përdorë, sipas disa studiuesve, veprën historike të Marin Barletit.

Të gjithë romantikët i përdorin ngjarjet historike nga vepra e Barletit, por përkaj historisë përsëri tek poema e Naimit, me përmendjen e personazhit të De Radës Bozdar Stresin, Naimi komunikon me veprën e De Radës “Skenderbeu i pafan”. Nëse analizohet detajisht, aty ka më tepër histori, luftëra, beteja, dhe ngjarje reale historike. Për dallim nga vepra e De Radës, këtu faktet historike janë në avantazh, në krahasim me fiksionin.

Radhitja e ngjarjeve historike në të dy poemat historike, atë të De Radës dhe të Naim Frashërit, është realizuar duke ndjekur rendin kronologjik, që korrespondon me ngjarjet historike. Kjo histori në poemat e përmendura realizohet, në fillim, me ardhjen e lajmëtarit që t`i ofrojë paqë Gjon Kastriotit, pastaj dërgimit peng të ardhmërisë së popullit, luftërat e Skenderbeut, vetëdijësimi me ndihmën e hijes së babait, kthimi në atdhe, luftrat e suksesshme për shqipëtarët dhe të huajt, martesja, lindja e femijës, vdekja e tij dhe largimi i familjes në Itali, duke përfunduar në luftrat e vazhdueshme për mbrojtjen e vendit dhe fitimi i lirisë së dëshiruar.

Paqën që ja ofroi sulltan Murati II i Turqisë, e pagoi Gjoni me të katër djemtë e tij, me pasardhësit e tij, por edhe me pasardhësit e Shqipërisë. Momentet e shprehjes së këtij pikëllimi që ia shponte zemrën tej për tej mbretit edhe gjithë shqiptarëve. Vargjet e paraqitura me mjeshtëri të rallë, paraqesin ndjenjën e dhimbjes së mbretit, ndjenjë kjo që mundohet ta ndaj me Kuvendin e Shqipërisë. Momentin e ndarjes së mbretit nga katër shtyllat e pallatit, djemtë e tij, vështirë e përballon zemra e çdo babai, por Naimi, nuk e lë të dorëzohet një mbret, i cili flijonte katër djemtë e tij për Shqipërinë. Një veprim i tillë, kaq patriot e madhështor nuk njihet në historinë e popujve tjerë:

“Ditën që do të shkonin,
Mbreti u ngritë që me natë,
Gjithë bota lot lëshonin
Edhe i varfëri atë,

Pastaj djemtë pran`i mori,
I puthi e i përqafojti,
Psherëtiti fort i gjori,
Lotët çurkë i lëshojti.”¹⁵⁰

Ishte shpresa, që e mbante gjallë mbretin. Ajo pikë e shpresës që një ditë do të kthehen djemtë e tij në Shqipëri. Ai nuk e dinte që nuk do të takohej më me ta, por e dinte se në trupin e tyre rrjedh gjaku i mbretit, i cili është i gatshëm të flijohet dhe të flijojë për atdheun.

¹⁴⁷ Sabri Hamiti, *Vetëdija letrare*, Rilindja, Prishtinë, 1989, faqe 259.

¹⁴⁸ Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi III*, Toena, Tiranë, 2000, faqe 264.

¹⁴⁹ Naim Frashëri, *Vepra 3, Historia e Skenderbeut*, Rilindja, Prishtinë, 1986, faqe 7.

¹⁵⁰ *Ibid.*, faqe 28.

Twelfth International Scientific Conference
KNOWLEDGE WITHOUT BORDERS
31.3-2.4.2017, Vrnjacka Banja, Serbia

Në poemë, Naimi krijon edhe trima të ngjajshëm me trimat e epopeve greke, që duke pasur besim dhe trimëri të dalin kundër kësaj çështjeje që ishte brenga e Shqipërisë. Kështu, bujari Kaman, ngriti zërin duke kërkuar që të luftohet më parë, sesa t'i falet ardhmëria e Shqipërisë të pabesit sulltan:

*"Mbreti plak u hoq më nj`anë,
Pa u ngrit një trim më këmbë
Shikoi një her`an`e m`banë,
Hekurin e haj me dhëmbë*
*Ish Kamani, q` ishte burrë,
Më trim nga gjithë të parët,
Nuk`i trembej syri kurrë
Pa e donin shqipëtarët..."¹⁵¹*

Studiuesit e Naimit janë shprehur se me portretizimin e këtij trimi "Naimi ka dashur të personifikojë të Kamani heroin, të cilin nuk i bën bef syri, që simbolizon trimërinë e paepur të popullit. Portreti i trimit dhe fjala e tij në mbledhjen e parësisë, janë ndër pjesët më të bukura të "Historisë së Skenderbeut". Naimi buçet bashkë me trimin e ri dhe çdo fjalë bëhet kushtrim i zjarrit."¹⁵²

Vepra e ruan kronologjinë e ngjarjeve, pas ndërhyrjeve të shkurtëra të Naimit. Paqen të cilën ia ofron Sulltani, Skenderbeu e pranon dhe kjo në vepër paraqitet në këto vargje:

*"Dy vjet qëndroj miqësia,
Lufta fare ishte prerë..."¹⁵³*

"Historia e Skenderbeut" e Naim Frashërit ndiqet nga fryma patriotike. Në këtë poemë autori përdorë edhe apostrofin, me anë të të cilit shpreh gëzimin dhe shpresën që ngjallet në popull me rastin e kthimit të heroit kombëtar në atdhe:

*"Kruj`o qytet i bekuar!
Prite, prite Skender-Benë,
Po vjen si pëllump i shkruar,
Të shpëtonjë mëmëdhenë..."¹⁵⁴*

Vet lloji i poemës që zgjedh për trajtim letrar, i mundëson autorit që herë t`ju referohet elementeve epike, atëherë kur dëshiron të përshkruaj ngjarje, e herë elementeve lirike, kur këto ngjarje i përshkruan me një tis emocional, shpesh duke i idealizuar. Kjo paraqet njëkohësisht edhe një tipar të romantizmit. Naimi në këtë poemë mbështetet edhe me filozofinë. Në këngën e XII, ai përdor filozofinë, derisa shkruan për ngritjen e ëndërruar të Skenderbeut në qiell. Sigurisht ky nuk është fakti i vetëm që dëshmon mbështetjen e dendur të Naimit me filozofinë.

Ai në Këngën "Sjell thijnët`e pleqërisë,
në mënyrë të Fishk faqen, kërrus kurrisënë,
momentet e Njerin`e than si murrinë!"¹⁵⁵
këtij heroi

XXI, paraqet
përkryer
plakjes së
kombëtar:

Paraqitja e shenjave të pleqërisë të Skenderbeu përshkruhen me aq sukses në vepër sa fitohet përshtypje që kjo nuk është periudha e plakjes, por është koha që e bën këtë ndryshim tek personazhi kryesor. Por ai vazhdon, duke e idealizuar pamjen e Skenderbeut:

*"Ti je një si Perendija
Shok s`ke dhe s`ke pasur kurrë,
Sa të jetë njerëzija
Më s`vjen si ti tjetër burrë..."¹⁵⁶*

De Rada dhe Naimi me veprat e tyre mbështeten në figurën historike, të Skenderbeut, me të cilin do të ndikojnë në vetëdijësimin e popullit shqiptar të kohës së tyre. Ky personazh, i posedon virtytet e larta njerëzore, që njëkohësisht na jep të kuptojmë se këta autorë komunikojnë me karakteristikat e romantizmit. Sipas, Rexhep Qoses "Njëjtësimi i këtyllë i figurës së Skenderbeut me fatin historik të popullit, doemos është arsyeja pse Naim Frashëri, e shikon atë prej anësh të ndryshme, duke i dhënë përmasa tepër të mëdha romantike."¹⁵⁷

Skenderbeu në këtë poemë është personazh boshtor, personazhet tjera janë në shërbim të realizimit të qëllimit historik. Hetueshmëria e të dhënave paratekstuale shihet edhe në emrat e personazheve, kronotopin (kohën

¹⁵¹ *Ibid.*, faqe 15.

¹⁵² *Historia e letërsisë shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1989, faqe 15.

¹⁵³ Naim Frashëri, *Vepra 3, Histori e Skenderbeut*, Rilindja, Prishtinë, 1986, faqe 262.

¹⁵⁴ *Ibid.*, faqe 83.

¹⁵⁵ *Ibid.*, faqe 302.

¹⁵⁶ *Ibid.*, 298.

¹⁵⁷ Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi III*, Toena, Tiranë, 2000, faqe 276.

dhe hapësirën) dhe numrat e ushtarëve. Në poemë përveç Skenderbeu, paraqiten edhe personazhe tjera. Përcaktimi i emrave historike edhe te personazhet tjera, luan rolin e komunikimit të poemës me historinë. Personazhet tjera historike janë Huniadi, Filipi i Burgondisë, mbreti Vlladislav i Polonisë etj. Këto personazhe edhe pse janë të zbehtë ose paraqiten vetëm njëherë, janë në shërbim të konkretizimit të dialogut letrar me epokën historike në një kontekst më të gjërë.

Koha e ngjarjes, poashtu, është dhënë në kronologji, ashtu si në historinë shqiptare. Por përveç emrave të personazheve hasen edhe toponime, emra gjeografikë, që vihen në shërbim të lokalizimit, të vendeve dhe të ngjarjeve historike. Përdorimi i numrave të ushtarëve shqiptarë ka qëllimin e paraqitjes së trimërisë shqiptare. Edhe pse mbështetja letrare e kësaj vepre me ngjarjet historike, heroin kombëtar, luftërat dhe betejat historike është e padiskutuar, përsëri Rexhep Qosja shprehet se: “qëndrimi i Naim Frashërit ndaj historisë, në thelb, është johistorik.”¹⁵⁸

Në gjithë poemën thënie dhe fjalimet, e paraqitura karakterizojnë zërin dhe idetë e autorit. Në disa raste, figura e Skenderbeut ngritet deri në qiell, duke fituar atributin “yll”. Në një mënyrë të tillë, autori e himnizon heroin kombëtar. “E gjithë poema “Istori e Skenderbeut” është thurur me ngjarje kolektive në të cilat personi i parë është heroi dhe rreth tij sillen të ndodhurat. Duket që kërkimi i një sitemi të tillë të këndimit këmbëngulës ka lënë manësh karakterizimet njerëzore individuale, qoftë të Skenderbeut, qoftë të trimave rreth tij.”¹⁵⁹

Kur lexohen vargjet e këngës së XIII, të “Istorisë së Skenderbeut”, atëherë gjejmë elemente të intertekstualitetit. Kësaj radhe ato janë reminishencat nga Danteja dhe Platoni. Kjo na jep të kuptojmë se autori nuk mund të shkëputet nga idetë e tij idealiste dhe mistike.

5. PËRFUNDIM

“Fryma dhe shpirti i epokës Skenderbejane, të cilat vepra e Naimit i solli të gjalla në çdo kasollë e zemër shqiptari, frymëzuan masat popullore për të çarë edhe kësaj here si kurdoherë, rrugën e historisë me shpatë në dorë. Kjo është merita më e madhe e veprës së Naimit, e cila ka luajtur atë rol frymëzues e qytetar që e vlen ta ketë zili çdo vepër arti. Ky është edhe sekret i fenomenit të madh të Naim Frashërit, i vendit të sigurt dhe të patundur që zuri vepra e tij në ndërgjegjen patriotike e artistike të kombit, sekret i pavdekësisë së poezisë së Naimit.”¹⁶⁰

Pra vendosja e paraleles mes së tashmes së hidhur dhe të kaluarës së ndritur ishte karakteristikë e kësaj periudhe. Mbështetja në histori dhe në figurën historike, duke përdorur teorinë e intertekstualitetit rezulton me sukses në veprat e autorëve të Rilindjes. Kjo mbështetje, e cila ka qëllim të ngritjes së vetëdijes, në njërin anë dhe përdorimin e historisë për fitimin e vlerave letrare në anën tjetër, hap mundësinë që veprat e kësaj periudhe të gjejnë mbështetje edhe në mitologji, që është në funksion të intertekstit.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Aristoteli, *Poetika*, Rilindja, Prishtinë, 1984.
- [2] Aristotel, *U pesnickoj umetnosti*, zavod za izdavanje ucebnika Socijalisticke Republike Srbije, Beograd, 1966.
- [3] *Historia e letërsisë shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1989.
- [4] J. Bulo, *Tradita dhe risi letrare*, Naim Frashëri, Tiranë, 1981.
- [5] J. De Rada, *Skenderbeu i pafan*, Rilindja, Prishtinë.
- [6] Letërsia dhe kultura arbëreshe, *Jeronim de Rada në 200 vjetorin e lindjes*, Rama graf, Elbasan, 2015.
- [7] L. Skendo, *Naim Frashëri*, Botimi i tretë, Tiranë, 1941.
- [8] M.SH. Veseli, *Aspekte të intertekstualitetit në letërsinë e Rilindjes kombëtare*, Tezë doktorati, 2017.
- [9] N. P. Gros, *Poetika e intertekstualitetit*, përkth. Urim Nerguti, Prishtinë, Parnas. 2001.
- [10] N. Frashëri, *Vepra 3, Historia e Skenderbeut*, Rilindja, Prishtinë, 1986.
- [11] R. Qosja, *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi II,III*, Toena, Tiranë, 2000.
- [12] S. Hamiti, *Studime letrare*, Seksioni i gjuhësisë dhe i letërsisë, Libri 21, Prishtinë, 2003.
- [13] S. Hamiti, *Vetëdija letrare*, Rilindja, Prishtinë, 1989.

¹⁵⁸ *Ibid.*, faqe 282.

¹⁵⁹ Sabri Hamiti, *Vetëdija letrare*, Rilindja, Prishtinë, 1989, faqe, 265.

¹⁶⁰ Jorgo Bulo, *Tradita dhe risi letrare*, Naim Frashëri, Tiranë, 1981, faqe 52.